



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Ejona" Sh.P.K. e datës 05.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe rregullimi i liftave të objekteve të komunës" me nr. të prokurimit 616-23-3831-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Ejona" Sh.P.K. e datës 05.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe rregullimi i liftave të objekteve të komunës" me nr. të prokurimit 616-23-3831-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Ejona" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Ejona" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 05.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe rregullimi i liftave të objekteve të komunës" me nr. të prokurimit 616-23-3831-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë formuluar si në vijim: "Edhe pse vendimi i OSHP-se per kete aktivitet citon: "është evidente se janë paraqitur 3 teknikë ndërsa dëshmitë lidhur me 2 prej tyre mungojnë, kështu që ky pretendim konform raportit të ekspertizës klasifikohet i bazuar," Pra, OE i shpallur fitues ka prezantuar diplomën si Teknik i ndërtimtarisë vetëm për 1 teknik, ndërsa për 2 të tjera ka dërguar diploma të degeve të tjera që nuk kanë të bëjnë me degen e ndërtimtarisë".

Fillimisht duhet sqaruar se pretendimi ankimor i referohet kërkesës në dosjen e tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional të formuluar si në vijim:

<b>2.Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme</b> <b>a.Inxhinier i diplomuar ose bachelor i elektroteknikes. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar së paku 1 kontratë të natyrës së ngjashme. b.Inxhinier i diplomuar ose bachelor i makinerisë. Minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë menaxhuar së paku 1 kontratë të natyrës së ngjashme. c. 3 teknikë të ndërtimtarisë Minimumi 3 vite përvojë pune në punë.</b>	<b>2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për inxhinierin e elektroteknikës dhe inxhinierin e makinerisë.</b>
---	--

Me datë 06.07.2023 parashtruesi ka dorëzuar në OSHP një ankesë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht me datë 08.11.2023 OSHP ka nxjerrë vendimin me nr. 2023/0471 në të cilin ndër të tjera në faqen me nr. 6 ka konstatuar si vijon: "Lidhur me kërkesën si në vijim, për 3 teknikë të ndërtimtarisë mund të nënkuptohet se si dëshmi janë kërkuar CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt ndërsa referencat i referohen inxhinierëve, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga palët si dhe nga shkresat e evidentuara të lëndës në e-prokurimi është evidente se janë paraqitur 3 teknikë ndërsa dëshmitë lidhur me 2 prej tyre mungojnë, kështu që ky pretendim konform raportit të ekspertizës klasifikohet i bazuar, megjithatë paneli konsideron se lidhur me këto dokumente me qenë se emrat e personave të angazhuar figurojnë në ofertën e OE të rekomanduar, në këtë rast konsiderohet se mund të aplikohen dispozitat e neneve 59 si dhe 72 të LPP-së, që në rastin konkret duke zërthyer paragrafët 1 dhe 3 të LPP-së të cilët lejojnë sqarimet dhe plotësimin e dokumentacionit". Duke u bazuar në këtë konstatim të Panelit Shqyrtues në OSHP ku autoriteti kontraktues udhëzohet që të kërkojë sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar, me datë 27.11.2023 autoriteti kontraktues ka pranuar nga tenderuesi i rekomanduar sqarimet shtesë ku janë bashkangjitur CV, Kontratat e punës si "teknikë të ndërtimtarisë" dhe diplomat e kërkuara për katër (4) teknikët e ndërtimtarisë të përcaktuar me listën e stafit profesional me të cilën ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Pra jo vetëm që janë dorëzuar dëshmitë e kërkuara sipas vendimit të OSHP por janë dërguar dëshmitë edhe për një (1) teknikë më shumë sesa që janë kërkuar me dosje të tenderit. Duhet sqaruar se në dosjen e tenderit lidhur me kërkesën për tre (3) teknikët e ndërtimtarisë janë kërkuar këto dëshmi dokumentare: 1. Kontrata e punës; 2. Diploma si dhe 3. CV. Kuptohet se kontrata e punës në këtë rast duhet të jetë e lidhur për pozitën "teknik të ndërtimtarisë" si staf profesional. Ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi. Ndërsa sipas dosjes së tenderit nuk janë kërkuar diplomat e fushës profesionale dhe as nuk është përcaktuar se për cilin nivel të shkollimit po kërkohet diploma. Përderisa në dosjen e tenderit nuk specifikohet diplomat e fushës profesionale por vetëm thuhet "diploma" atëherë aludimi i parashtruesit është i pabazuar në tërësi.

Ngjashëm thuhet edhe sa i përket "CV" pra nuk përcaktohet lloji ose forma e CV. Përndryshe parashtruesi ka pasur mundësinë në faza të mënherhme të aktivitetit të prokurimit që të kontestoj edhe mënyrën se si është formuluar kërkesa e dosjes së tenderit për të cilën po bëhet mirëpo nuk ka bërë një veprim të tillë. Rrjedhimisht kërkesa ku kërkohet "diploma" pa specifikuar më tutje asgjë tjetër është e pakontestueshme as nga parashtruesi por as nga Paneli Shqyrtues në vendimin e cituar më sipër. Prandaj Paneli Shqyrtuar në vendimin e cituar më sipër udhëzon AK vetëm që të kërkoj sqarime shtesë. Pikërisht në këtë mënyrë komisioni vlerësues ka vepruar me rastin e rivlerësimit. Rrjedhimisht me datën 27.11.2023 tenderuesi i rekomanduar i ka dërguar dëshmitë e kërkuara dokumentare për teknikët e ndërtimitarisë saktësisht sikurse janë kërkuar me dosjen e tenderit. Për këto arsye, pretendimet e parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.12.2023



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.